



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 789/10 prot.

Tiranë më 06.9.2019

V E N D I M

Nr. 27, datë 06.9.2019

P Ë R

LEJIMIN E TRANSFERIMIT NDËRKOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 9 dhe pikës 1 të nenit 26 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës administruar me nr. 789/5 prot, datë 15.07.2019, për pajisje me autorizim për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale nga transferuesi **ProCredit Bank sh.a** tek marrësi **ProCredit Bank** në Republikën e Kosovës.

KONSTATOVA SE:

Subjekti kontrollues, ProCredit Bank sh.a ka kërkuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") pajisjen me autorizim për transferimin e të dhënave personale tek marrësi ProCredit Bank e vendosur në Kosovë.

Sipas deklarimeve të subjektit në Formularin e Aplikimit për aprovimin e transferimit të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, administruar pranë Zyrës së Komisionerit, transferimi që kërkohet të autorizohet nga Komisioneri përmban elementët e mëposhtëm:

Kategoria e të dhënave objekt transferimi:

1. Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër, gjinia, inicialet, vendlindja, datëlindja);
2. Numri personal i identifikimit;
3. Jeta profesionale;
4. Numri i sigurimit shoqëror;
5. Situata ekonomike e financiare;
6. Formimi, diplomat, medaljet;
7. Adresa (karakteristikat e banesës);
8. Foto;
9. Shëndeti;

10. Anëtarësimi në bashkime sindikatah;
11. Gjendja gjyqësore.

Shteti ku do të realizohet transferimi: Kosovë.

Kategoria e subjekteve të cilëve u transferohen të dhëna personale janë: Punëmarrës.

Frekuenca e Transferimit është: Vazhdimisht, mbi bazë ditore.

Qëllimi i transferimit, citojmë: *“Të dhënat e sipërpërmendura do të transferohen në Kosovë si rezultat i marrëveshjes dypalëshe mes ProCredit Bank Shqipëri dhe ProCredit Bank e vendosur në Kosovë për kryerjen e disa proceseve të punës të lidhura me burimet njerëzore nga ProCredit Bank Kosova në emër dhe për llogari të ProCredit Bank Shqipëri”.*

Ndërkohë në Rubrikën 7, të Formularit të Aplikimit “Rrethanat lidhur me përpunimin” subjekti transferues ka deklaruar, citojmë: *“Përdoruesit e ProCredit Bank në Kosovë do të aksesojnë të dhënat vetëm për qëllimin e deklaruar në marrëveshjen dypalëshe lidhur me bashkëpunimin cilësor midis dy bankave, me qëllim edhe të rritjes së efikasitetit të organizimit dhe shërbimeve në të dy institucionet, disa procese të lidhura me burimet njerëzore janë planifikuar që të kalojnë në Kosovë te ky subjekt”*

Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave, citojmë: *“Kohëzgjatja e përpunimit të të dhënave do të jetë jo më gjatë se tre muaj, siç është përcaktuar në kontratën dypalëshe mes ProCredit Bank Shqipëri dhe ProCredit Bank e vendosur në Kosovë”.*

Në bazë të Vendimit të Komisionerit Nr. 8, datë 31.10.2016 “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”, Kosova nuk përfshihet në listën e vendeve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave.

Në këto kushte në zbatim të nenit 9 pika 1, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, subjekti kontrollues ProCredit Bank Shqipëri është në kushtet ku ky transferim duhet kryer pas marrjes së Autorizimit nga Komisioneri mbi ligjshmërinë e realizimit të tij.

Për këtë qëllim subjekti përveç Formularit të Aplikimit ka depozituar një sërë dokumentesh në mbështetje të kërkesës së tij për të legjitimuar transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale në marrësin e sipërcituar dhe konkretisht:

- Kontratën për transferimin e të dhënave lidhur ndërmjet ProCredit Bank Shqipëri dhe ProCredit Bank e vendosur në Kosovë;
- Aneksi nr. 4 i kontratës lidhur me përpunimin e të dhënave personale;
- Deklaratën e Pëlqimit të subjekteve të të dhënave “Punëmarrës” të cilëve u transferohen të dhëna personale;
- Kodi Etikës i ProCredit Bank Shqipëri.
- Informacion plotësues lidhur me kërkesën për autorizimin e transferimit në një shtet pa nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale

Në mbështetje të dokumentacionit të paraqitur nga kontrolluesi dhe studimi i përmbajtjes së tyre rezultoi se ky transferim të dhënash personale është në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale sipas akteve ndërkombëtare dhe vendase, dispozitat e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Udhëzimit nr. 41, datë 13.06.2014 për "Lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale".

Sa më sipër, kërkesa për marrjen e autorizimit nga Komisioneri për transferimin e të dhënave personale nga kontrolluesi ProCredit Bank Shqipëri plotëson kërkesat ligjore për t'u pajisur me Autorizim për transferimin e të dhënave personale të kërkuara.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, shkronja b, c nenit, 9 pika 2 dhe nenit 26 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar;

### **V E N D O S A :**

1. Lejimin e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale nga kontrolluesi ProCredit Bank Shqipëri, duke përcaktuar si më poshtë:

Kontrolluesi ProCredit Bank Shqipëri lejohet të transferojë tek marrësi i të dhënave ProCredit Bank e vendosur në Kosovë kategorinë e të dhënave personale të punëmarrësve, si më poshtë:

- Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër, gjinia, inicialet, vendlindja, datëlindja);
  - Numri personal i identifikimit;
  - Jeta profesionale;
  - Numri i sigurimit shoqëror;
  - Situata ekonomike e financiare;
  - Formimi, diplomat, medaljet;
  - Adresa (karakteristikat e banesës);
  - Foto;
  - Shëndeti;
  - Anëtarësimi në bashkime sindikatash;
  - Gjendja gjyqësore.
2. Të dhënat e cituara më sipër do të transferohen vetëm për qëllimin e deklaruar nga transferuesi në Formularin e Aplikimit për autorizim mbi transferimin e të dhënave personale, të paraqitur pranë Komisionerit dhe që ka të bëjë me kryerjen e disa proceseve të punës të lidhura me burimet njerëzore.

3. Të dhënat personale të lejuara për t'u transferuar (parashikuar në pikën 1), nuk do të ruhen për asnjë moment jashtë sistemeve bankare të ProCredit Bank Shqipëri. ProCredit Kosovë nuk do të ketë asnjë të drejtë të bëjë arkivimin e të dhënave por vetëm aksesimin e tyre në kohë reale për qëllim të kryerjes së shërbimeve të përmendura në pikën dy.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot më datë 26/9 /2019

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

